




ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

# Raport: Struktura e Eksportit dhe Importit në Kosovë

---

Prishtinë, 2024



Publikuar nga:  
Oda Ekonomike e Kosovës

Bul. Nëna Terezë, Nr.20.  
10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës  
Fix: +383 (0) 38 224 299

[info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org)  
[www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org)

Prishtinë, 2024






## Informacione rreth Analizës

Kjo analizë është përgatitur nga Oda Ekonomike e Kosovës në kuadër të Departamentit për Analiza dhe Komunikim Strategjik. Raporti paraqet një vështrim të indikatorëve kryesorë makroekonomikë dhe strukturës së tregtisë së eksportit dhe importit në Kosovë. Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë Produktin Vendor Bruto, normën e inflacionit, eksportin dhe importin, si dhe të identifikojë partnerët kryesorë të Kosovës në tregtinë e jashtme, kategoritë kryesore të mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023.

Përmes analizës së këtyre treguesve kryesorë makroekonomikë synohet të ofrohen informacione që ndihmojnë sektorin privat të kuptojnë trendët e zhvillimit, strukturën e tregtisë së jashtme, ndryshimet në normën e inflacionit, dhe si dhe partnerët kryesorë në bashkëpunimin ndërkombëtar. Gjithashtu, ky proces analitik shërben si bazë për marrjen e vendimeve strategjike në zhvillimin e biznesit, duke identifikuar sektorët dhe strukturën e tregtisë me potencial për rritje dhe investime.



## Përmbajtje

Informacione rreth Analizës .....	3
1. Hyrja.....	6
2. Metodologjia .....	8
3. Treguesit Kryesor Makroekonomik .....	9
3.1. Rritja reale e Bruto Produktit Vendor ndër vite .....	9
3.2. Ndërmarrjet e regjistruara në Kosovë.....	10
3.3 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit.....	11
4. Eksportit dhe Importi në Kosovë.....	12
4.1. Top partnerët tregtarë të Kosovës.....	15
4.2. Top kategoritë e Eksportit dhe Importit për Shërbime .....	17
4.3. Eksporti-Importi sipas vendeve gjatë viteve 2020-2023 .....	19
Referencat.....	21

## Lista e figurave

Figure 1 Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak .....	9
Figure 2 Ndërmarrjet sipas tremujorit ndërmarrjet e reja/të shuara .....	10
Figure 3 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit - Ndryshimi vjetor në përqindje. ....	11
Figure 4 Qarkullimi mujor i mallrave me tregtinë e jashtme sipas tremujorëve 2022-2023.....	12
Figure 5 Qarkullimi vjetor I mallrave në tregtinë e jashtme .....	12
Figure 6 Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në përqindje.....	13
Figure 7 Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në përqindje .....	14
Figure 8 Partneret Kryesor te Eksportit 2020-2023.....	15
Figure 9 Partneret Kryesor sipas Importit 2020-2023 .....	16
Figure 10 Top kategoritë e eksportit të shërbimeve gjatë 2020-2023 ( në mil Eur).....	17
Figure 11 Top kategoritë e importit të mallrave dhe shërbimeve gjatë 2020-2023 ( në milionë Euro) ...	18
Figure 12 Eksporti ndër vite 2020-2023 sipas vendeve në përqindje.....	19
Figure 13 Importi ndër vite 2020-2023 sipas vendeve në përqindje. ....	20

## Lista e shkurtesave

BPV – Bruto Produkti Vendor  
OEK – Oda Ekonomike e Kosovës  
ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës  
ATK – Agjencia Tatimore e Kosovës  
BB – Banka Botërore

## 1. Hyrja

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, pritet që aktiviteti ekonomik në vend të shënojë një rritje prej rreth 4.2 për qind në vitin 2024. Kjo projeksion sugjeron se kjo rritje do të gjenerohet nga një kombinim i kërkesës brenda vendit, rritjes së konsumit dhe investimeve si dhe eksportit. Në këtë kontekst, politikat dhe strategjitë që inkurajojnë zhvillimin e eksportit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së industrive vendase shfaqen si të domosdoshme për të përbushur potencialin e rritjes së ekonomisë. Kosova duhet të ndërmarrë veprime për të shtuar përpjekjet në rritjen e eksportit dhe për të reduktuar deficitin tregtar që është një sfidë për ekonominë për një kohë të gjatë.


Analiza për periudhën 2020-2023 ofron një pasqyrë të detajuar rreth eksportit, importit dhe balancës tregtare të Kosovës, duke identifikuar top vendet partnere dhe top produktet më të eksportuara dhe importuara gjatë kësaj periudhe. Në veçanti, për tremujorin e katërt të vitit 2023, paraqitet një përmbledhje e rëndësishme e situatës së tregtisë së mallrave dhe shërbimeve në Kosovë. Eksporti dhe importi janë dy tregues që shprehin orientimin dhe nivelin e pjesëmarrjes së një vendi në tregun ndërkombëtar. Në këtë kontekst, rëndësi të madhe ka pjesëmarrja aktive në tregun ndërkombëtar pasi që sjell shumë avantazhe për një vend. Ajo nxit zhvillimin e industrive vendase, rrit punësimin, stimulon investimet dhe kontribuon në rritjen e të ardhurave kombëtare.

Sipas të dhënave të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, tregtia e mallrave dhe shërbimeve në Kosovë për katër vitet që janë analizuar ka treguar një deficit tregtar të përcjellur për një periudhë të gjatë. Në muajin dhjetor të vitit 2023, eksporti ka pasur një vlerë prej 65.4 milion euro, ndërsa importi ka arritur në 543.1 milion euro. Eksporti mbulon importin 12%. Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë (21.0%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (18.5%) artikujt të ndryshëm të prodhuar, (13.9%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (13.4%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (5.8%) Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, etj.

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë (13.6%) produktet minerale, (13.1%) ushqime të përgatitura, pije dhe duhan, (12.1%) mjetet e transportit, (11.5%) makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, (8.8%) metalet bazë dhe artikuj prej tyre, etj.

Këto të dhëna tregojnë një strukturën e eksportit dhe importit në Kosovë, me një peshë të rëndësishme të produkteve të metaleve bazë dhe artikujve prej tyre në eksport, ndërsa importi është i dominuar nga produktet minerale dhe ushqimet e përgatitura.

Sipas tregtisë së jashtme të mallrave me 27 vendet e Bashkimit Evropian, eksportet e Kosovës në këto vende arritën në 18.7 milion euro, ose rreth 28.6% e eksporteve të përgjithshme, duke treguar një ulje prej 2.1%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në Bashkimin Evropian janë Gjermania me 10.0%, Italia me 4.2%, Holanda me 2.1%, dhe vende të tjera të BE-së. Importet e Kosovës nga vendet e Bashkimit Evropian ishin rreth 225.3 milion euro, ose 47.0% e importeve të përgjithshme, duke treguar një rritje prej 17.5%. Disa nga vendet me pjesëmarrje më të lartë në importet e Kosovës përfshijnë Gjermaninë me 14.8%, Greqinë me 5.6%, dhe Italinë me 4.3%.



Në muajin dhjetor 2023, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 28.0 milion euro, ose 42.7% të eksporteve të përgjithshme, duke treguar një ulje prej 5.9%. Partnerët kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-së janë Shqipëria me 18.3%, Maqedonia e Veriut me 12.5%, Serbia me 5.8%, dhe Mali i Zi me 4.9%. Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-së në muajin dhjetor 2023, arritën në 69.1 milion euro, ose 12.7% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej 25.5%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin Shqipëria me 5.4%, Maqedonia e Veriut me 4.4%, dhe Serbia me 1.8%. Eksportet e Kosovës me vendet tjera arritën në 18,7 milion euro, ose (28.7%).

## 2. Metodologjia

Analiza e Strukturës së Eksportit dhe Importit në Kosovë nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 synon të japë një panoramë të plotë dhe të detajuar të zhvillimeve në tregtinë jashtme të vendit gjatë këtyre katër viteve. Kjo analizë ka për qëllim të sigurojë informacion të rëndësishëm për bizneset dhe aktorët relevantë në lidhje me performancën e ekonomisë së Kosovës në fushën e eksportit dhe importit.

OEK ka për qëllim të ofrojë një analizë të detajuar të ecurisë së eksportit dhe importit në Kosovë, duke përdorur të dhëna zyrtare nga burime të besueshme si Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës. Ky proces analize përdor një metodologji kuantitative, duke u bazuar në analizën e të dhënave sekondare, të cilat janë të mbledhura dhe të disponueshme për periudhën e studiuar. Në këtë analizë, janë vlerësuar disa aspekte të ekonomisë së Kosovës, duke përfshirë aktivitetet ekonomike, prodhimin vendor, inflacionin, numrin e ndërmarrjeve të regjistruara, si dhe eksportin dhe importin e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, janë identifikuar dhe analizuar top partnerët tregtar dhe kategoritë e rëndësishme të eksportit dhe importit gjatë periudhës së studiuar.

Metodologjia e këtij raporti është bazuar në përdorimin e një metodologjie kuantitative, e cila ka përfshirë analizën e të dhënave sekondare. Kjo do të thotë se për të mbledhur dhe analizuar të dhënat, janë përdorur burime të dhënash të cilat janë tashmë të disponueshme. Duke u përqendruar në të dhënat ekzistuese dhe duke i analizuar ato nëpërmjet një qasjeje kuantitative, studimi ka mundësuar identifikimin e tendencave, marrëdhënieve, dhe shënimeve të rëndësishme në lidhje me eksportin, importin, dhe performancën ekonomike të vendit. Kjo metodologji ka siguruar një bazë të qëndrueshme për të vlerësuar dhe interpretuar zhvillimet në ekonominë e Kosovës.




### 3. Treguesit Kryesor Makroekonomik

#### 3.1. Rritja reale e Bruto Produktit Vendor ndër vite

Figura 1 ofron një pasqyrë të Bruto Produktit Vendor (BPV) për periudhën 2020-2023. Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurë, vërehet një rritje reale e BPV-s prej 3% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Nëse shqyrtojmë të dhënat ndër vite, vërejmë një tendencë të rritjes së ngadalshme, por të qëndrueshme që nga tremujori i dytë i vitit 2022.

Ky grafik ofron një perspektivë të rëndësishme mbi performancën e ekonomisë së Kosovës gjatë periudhës së studiuar. Rritja e BPV-s është një indikator i rëndësishëm i shëndetit ekonomik të një vendi, dhe rritja e treguar gjatë kësaj periudhe tregon për një përparim gradual në aktivitetin ekonomik.

Figure 1 Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak




Burimi: Statistikat e Llogarive Kombëtare Bruto Produkti Vendor, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

### 3.2. Ndërmarrjet e regjistruara në Kosovë

Në tremujorin e katërt të vitit 2023 (TM4) gjithsej janë regjistruar 2 821 ndërmarrje. Në TM4 2023 krahasuar me tremujorin paraprak (TM3 2023) kemi rrënjë për -1.08% të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2022) kemi rritje për 7.01% të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 718 (25.5%), Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 306 (10.8%), Ndërtimtari me 283 (10%), Prodhim me 253 (9%), etj. Sa i përket numrit të bizneseve të shuara, gjatë këtij tremujori janë mbyllur gjithsej 397 biznese, që paraqet një rritje të normës së shuarjes krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve, 2023).

Figure 2 Ndërmarrjet sipas tremujorit ndërmarrjet e reja/të shuara



Burimi: Statistikat mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


### 3.3 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Presionet mbi inflacion shënuan një rritje të lehtë në fund të këtij tremujori, duke reflektuar rritjen e çmimeve të energjisë, ndërsa inflacioni bazë tregoi tendenca ulëse. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2023 ishte më i lartë krahasuar me vitin 2022 në një mesatare prej (4,9 %). Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,8% në muajin janar 2024, krahasuar me muajin janar 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemë (13,6%); peshk (9,7%); perime (9,3%); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (7,5%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (7,2%), etj. (Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike, 2023).

Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-8,5%); vajra dhe yndyra (-7,8%); qumësht, djathë dhe vezë (-3,9%); dhe blerje e automjeteve (-2,1%), etj. (Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike, 2023).

Kjo figurë përmban tabelën Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Kosovë në baza mujore Janar 2022 – Janar 2024.

Figure 3 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit - Ndryshimi vjetor në përqindje.




Burimi: Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

## 4. Eksportit dhe Importi në Kosovë


Sipas të dhënave nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë, mund të themi se kemi një deficit tregtar të vazhdueshëm ndër vite ku mund të shihet dhe në figurën numër pesë ku tregon për një deficit tregtar më të larët për (6.3%) në muajin dhjetor 2023, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 477,7 milion euro krahasuar me deficitin 449,5 milion euro në vitin 2022.

Figure 4 Qarkullimi mujor i mallrave me tregtinë e jashtme sipas tremujorëve 2022-2023



Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Figure 5 Qarkullimi vjetor I mallrave në tregtinë e jashtme



Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Eksporti mbulon importin (12.0%). Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2023 kishte vlerën 65,4 milion euro, ndërsa importi 543,1 milion euro, është një ulje prej (9.3%) për eksport si dhe një rritje prej (4.1%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit të paraqitura në figurën gjashtë e përbëjnë: (21.0%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (18.5%) artikuj të ndryshëm të prodhuar, (13.9%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (13.4%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (5.8%) makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, etj. (Tregtia e Jashtme e Mallrave, 2023).


Figure 6 Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në përqindje



Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Sipas të dhënave të grupeve kryesor për import ku shihet në figurën shtatë e përbëjnë: (13.6%) produktet minerale, (13.1%) ushqime të përgatitura, pije dhe duhan, (12.1%) mjetet e transportit, (11.5%) makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, (8.8%) metalet bazë dhe artikuj prej tyre, etj. (Tregtia e Jashtme e Mallrave, 2023)

Figure 7 Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në përqindje




Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

## 4.1. Top partnerët tregtarë të Kosovës

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për top partneret tregtar sa i përket eksportit për gjatë viteve 2020 – 2023. Në vitin 2020, partnerët kryesorë tregtarë për eksportin e Kosovës ishin: Shqipëria (23.2%), Maqedonia e Veriut (9.3%), Gjermania (9.3%) dhe Zvicra (8.2%).

Në vitin 2021, partnerët kryesorë tregtarë për eksportin e Kosovës ishin: SHBA (14.8%), Shqipëria (14.7%), Maqedonia e Veriut (11.5%) dhe Gjermania (8.2%). Në vitin 2022, partnerët kryesorë tregtar ishin: SHBA (14.8%), Maqedonia e Veriut (12.9%) dhe Shqipëria (11.1%). Gjatë vitit 2023, partneret kryesorë tregtar ishin: Maqedonia e Veriut (14.2%), Shqipëria (13.4%), SHBA (12.3%) dhe Gjermania (10.9%).

Figure 8 Partneret Kryesor te Eksportit 2020-2023




Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Në këtë pjesë, paraqiten partnerët kryesorë tregtarë për importin në Kosovë në periudhën 2020-2023, duke përqendruar vëmendjen në përqindjet dhe ndryshimeve në këtë periudhë kohore. Në vitin 2020, partnerët kryesorë tregtarë për importin në Kosovë ishin: Turqia (12.4%), Gjermania (13.0%) dhe Kina (9.8%). Në vitin 2021, partnerët kryesorë tregtar ishin: Gjermania (13.1%), Turqia (12.5 %), dhe Kina (9.7%).

Gjatë vitit 2022, partnerët kryesorë tregtarë për importin ishin: Turqia (14.9%), Gjermania (10.8%) dhe Kina (9.7%). Gjatë vitit 2023, Gjermania ishte partneri kryesorë tregtar sa i përket importit, duke zënë një përqindje prej 10%, pasuar nga Turqia (8.6%) dhe Serbia (8.7%).

Figure 9 Partneret Kryesor sipas Importit 2020-2023



Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)




## 4.2. Top kategoritë e Eksportit dhe Importit për Shërbime

Në këtë pjesë, prezantohen të dhënat rreth top kategorive të eksportit të shërbimeve në Kosovë për periudhën 2020-2023.

Në vitin 2023, në theks të veçantë shërbimet e udhëtimit kanë arritur shumën prej 2,127miliardë euro, pasuar nga shërbimet kompjuterike me 284 milionë euro, shërbimet tjera të biznesit me 196 milionë euro, transporti me 125 milionë euro dhe ndërtimi me 34 milionë euro.


Figure 10 Top kategoritë e eksportit të shërbimeve gjatë 2020-2023 ( në mil Eur)



Burimi: Statistikat mbi Shërbimet, Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur top kategoritë e importit të shërbimeve për vitet 2020 – 2023. Gjatë vitit 2023, kategoria e shërbimeve të udhëtimit arriti në 625 milionë euro, pasuar nga kategoria e transportit me 270 milionë euro, shërbimet tjera të biznesit me 186 milion euro, shërbimet kompjuterike dhe informative me 96 milionë euro dhe ndërtimi me 89 milion euro.

Figure 11 Top kategoritë e importit të mallrave dhe shërbimeve gjatë 2020-2023 ( në milionë Euro)




Burimi: Statistikat mbi Shërbimet, Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

### 4.3. Eksporti-Importi sipas vendeve gjatë viteve 2020-2023

Eksporti i shërbimeve është një segment i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe diversifikimin e tregut të punës. Në Figurën 12, shihet pasqyra e eksportit të shërbimeve për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 sipas partnereve tregtar duke përfshirë eksportin me 27 vendet e Bashkimit Evropian (BE-së vendet e CEFTA-së, vendet e EFTA-së, vendet evropiane të tjera, vendet jo evropiane, vendet e Azisë dhe vendet e tjera.

Në bazë të figurës së mëposhtme, vërehet një përqindje më e lartë e eksportit me vendet e CEFTA-së dhe vendet e BE-së në krahasim me vendet tjera. Kjo tregon një orientim të qartë drejt tregjeve të afërta dhe tregjeve të Bashkimit Evropian për eksportin e shërbimeve të Kosovës.

Figure 12 Eksporti ndër vite 2020-2023 sipas vendeve në përqindje.




Burimi: Statistikat mbi Shërbimet, Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

Në Figurën 13, paraqitet importi i Kosovës për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, i ndarë në kategori të partnereve tregtar. Këto kategori përfshijnë: 27 vendet e Bashkimit Evropian (BE-së), CEFTA, EFTA, vendet tjera evropiane, vendet e tjera jo evropiane, vendet e Azisë dhe vende të tjera.

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), vërehet se Kosova ka importuar më së shumti me 27 vendet e BE-së, CEFTA-së, vendet tjera evropiane, dhe vendet e Azisë. Kjo tregon për një trend ku importi i shërbimeve i Kosovës përqendrohet kryesisht në partnerët e saj në Evropë, duke reflektuar lidhjet e forta tregtare dhe ekonomike me këtë rajon.

Figure 13 Importi ndër vite 2020-2023 sipas vendeve në përqindje.



Burimi: Statistikat mbi Shërbimet, Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

## Referencat

- European Center Bank.* (a.d.). Gjetur në <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/ecbu/eb202307.en.pdf>.
- ASK. (a.d.). *ASK*. Gjetur në <https://askapi.rks-gov.net/Custom/170867eb-a285-4b7b-a9e3-9dc5b95ecd0b.pdf>.
- ASK. (a.d.). *BPV*. Gjetur në <https://askapi.rks-gov.net/Custom/7be58c36-5f25-468e-8ec1-b509e0ecea95.pdf>.
- BQK. (a.d.). *bqk-kos.org*. Gjetur në ÇKA ËSHTE BRUTO PRODUKTI VENDOR?: <https://bqk-kos.org/edu/wp-content/uploads/2021/08/cka-eshte-Bruto-Produkti-Vendor-7.pdf>
- Financial Times.* (a.d.). Gjetur në US economic growth accelerated in third quarter: <https://www.ft.com/content/8409fd04-90f4-490b-af08-c9b67a36077c>
- Kosovë, A. i. (2023). *Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve*.
- Kosovës, A. i. (2023). *Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike*. Prishtinë. Gjetur në ASK-Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale, 2010TM1 - 2023TM3: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_\\_National%20and%20government%20accounts\\_\\_National%20accounts\\_\\_Quarterly%20national%20accounts/BPV\\_Current02.px/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__National%20and%20government%20accounts__National%20accounts__Quarterly%20national%20accounts/BPV_Current02.px/)
- Kosovës, A. i. (2023). *Tregtia e Jashtme e Mallrave*. Gjetur në <file:///C:/Users/svokshi/OneDrive%20-%20Kosovo%20Chamber%20of%20Commerce/Desktop/Dhjetor%202023.pdf>: <file:///C:/Users/svokshi/OneDrive%20-%20Kosovo%20Chamber%20of%20Commerce/Desktop/Dhjetor%202023.pdf>
- KOSOVES, B. B. (a.d.). *BANKA BOTERORE E KOSOVES*. Gjetur në Global Economic Prospects: <https://openknowledge.worldbank.org/collections/09c5e8fc-187f-5c2f-a077-3e03044c7b62>
- TJM, A. e. (a.d.). *Tregtia e Jashtme e Mallrave ASK*. Gjetur në <https://askapi.rks-gov.net/Custom/c68e67f0-4518-4883-9ea3-9186c94b792b.pdf>.